



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Këshilli Kombëtar i Ujit**

**V E N D I M**

**Nr.2, datë 27.7.2012**

**PËR**

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1, DATË 7.7.2011, TË KËSHILLIT**  
**KOMBËTAR TË UJIT, “PËR MENAXHIMIN E SHFRYTËZIMIT**  
**TË ZHAVORREVE PËR NDËRTIMIN E RRUGËVE”**

Në mbështetje të neneve 6 dhe 24, të ligjit nr.8093, datë 21.3.1996, “Për rezervat ujore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli Kombëtar i Ujit

**V E N D O S I:**

Pika 1, e vendimit nr.1, datë 7.7.2011, të Këshillit Kombëtar të Ujit, riformulohet, si më poshtë vijon:

“1. Për nevoja të ndërtimit të segmenteve rrugore, me rëndësi kombëtare dhe rajonale, të cilat janë financuar nga buxheti i shtetit dhe/ose financohen nga marrëveshje kredie të ratifikuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, të lejohet shfrytëzimi i inerteve lumore në çdo basen, sipas studimeve të kryera nga firmat kontraktore dhe të miratuara nga këshillat e baseneve ujëmbledhëse, përkatës.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SALI BERISHA**

**KRYETAR**